



**INSTITUCIONET E PËRKOHSHME TË VETËQEVERISJES  
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT  
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLANJA**

**QEVERIA E KOSOVËS - GOVERNMENT OF KOSOVO - VLADA KOSOVA**

**MINISTRIA E PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE  
MINISTRY OF LABOUR AND SOCIAL WELFARE  
MINISTARSTVO RADA I SOCIJALNE ZAŠTITE**

**AGJENCIONI EKZEKUTIV I INSPEKTORATIT TË PUNËS**

Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, në zbatim dispozitës së nenit 1 paragrafi 1.6 të Rregullores Nr.2001/19, mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetqeverisjes në Kosovë,

në mbështetje të dispozitave të nenit 2(2.4 dhe 2.7), të nenit 6 dhe të nenit 16 të Ligjit Nr:2003/19, për Siguri në Punë, Mbrojtje të Shëndetit të Punësuarve dhe Ambientit të Punës,

me qëllim të ndërmarrjes së masave parandaluese për evitimin e rreziqeve në punë, nxjerr :

**RREGULLOREN Nr.2004/02  
PËR VLERËSIMIN E RREZIKSHMËRISË NË PUNË DHE LIDHUR ME PUNËN  
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

**Neni 1.**

**1.1.** Në kuptim të dispozitave të kësaj Rregullore, vlerësim i rrezikshmërisë në punë dhe lidhur me punën, është procedura me të cilën parashihet rreziku për lëndim në punë, sëmundje profesionale dhe sëmundje tjera lidhur me punën, si dhe çrregullimet në procesin e punës të cilat mund të shkaktojnë pasoja të dëmshme për siguri në punë, shëndet të punësuarve dhe mjedis të punës.

**1.2.** Detyrim për të bërë vlerësimin e rrezikshmërisë në punë dhe lidhur me punën, kanë punëdhënësit në lëmin e industrisë, ndërtimtarisë, bujqësisë, pylltarisë, shëndetësisë, komunikacionit, institucionet për aftësim profesional, institucionet arsimore me laborator dhe puntori për punë praktike, si dhe të gjithë punëdhënësit ku ekziston rreziku për lëndim në punë, sëmundje profesionale, çrregullime tjera në procesin e punës e që mund të kanë

pasoja të dëmshme për siguri në punë, mbrojtje të shëndetit të punësuarve dhe mjedis të punës.

**1.3.** Me rastin e hartimit të vlerësimit të rrezikshmërisë në punë dhe lidhur me punën, aplikohen rregullat e sigurisë në punë, të cilat i parashohin masat e duhura dhe **përkatëse** për evitimin e rrezikshmërisë të të punësuarve në vende dhe mjedise të punës.

**1.4.** Me këtë Rregullore, përcaktohen kushtet të cilat duhet ti plotësojnë punëdhënësit dhe institucionet tjera të autorizuara për hartimin e vlerësimit të rrezikshmërisë në punë dhe lidhur me punën, metodologjitë dhe përmbajtjet e përcaktimit të rreziqeve në punë, si dhe të dhënat në të cilat duhet bazuar.

**1.5.** Me rastin e hartimit të vlerësimit të rrezikshmërisë në punë duhet patur parasysh procesin e punës, të punësuarin dhe mjedisin e punës.

**1.6.** Vlerësimi i rrezikshmërisë në punë dhe lidhur me punën, bëhet duke hulumtuar identifikuar, evidentuar, inçizuar dhe analizuar çdo vend pune në kontest të rrezikshmërisë e nga kjo të nxjerren përfundime adekuate për evitimin e rrezikshmërisë në punë.

**1.7.** Punëdhënësi i bartë të gjitha shpenzimet materiale, për hartimin dhe implementimin e vlerësimit të rrezikshmërisë në punë dhe lidhur me punën.

**1.8.** Punëdhënësi, është i obliguar që vlerësimin e rrezikshmërisë në punë dhe lidhur me punën, ta publikoi në vende të theksuara, në mënyrë që me përmbajtjen e tij detalisht të informohen të gjithë të punësuarit.

## **P Ë R M B A J T J A**

### **E VLERËSIMIT TË RREZIKSHMËRISË NË PUNË DHE LIDHUR ME PUNËN**

#### **Neni 2.**

Vlerësimi i rrezikshmërisë në punë dhe lidhur me punën përmban:

**2.1.** shënimet e përgjithshme;

**2.2.** shënimet përkitazi me gjendjen ekzistuese;

**2.3.** analizën dhe vlerësimin e shënimeve të grumbulluara;

**2.4.** planin e masave që duhet ndërmarrë për evitimin e rrezikshmërisë në punë dhe lidhur me punën,

**2.5.** dokumentacionin tjetër që i bashkëngjitet vlerësimit të rrezikshmërisë në punë dhe lidhur me punën.

#### **Neni 3.**

**3.1.** Shënimet e përgjithshme përmbajnë të dhënat për:

**a)** punëdhënësin;

**b)** objektet e dedikuara për punë dhe ato përcjellëse;

**c)** kryesin e punëve;

**ç)** personat e autorizuar;

**d)** ekspertët e sigurisë në punë

**dh)** personin e autorizuar të sigurisë në punë i cili ka marrë pjesë në caktimin e rrezikshmërisë në punë dhe

**e)** ekspertët e jashtëm (nëse ka);

**3.2.** Është detyrim i punëdhënësit, bashkë me punëmarrësit, ta trajtojnë drejtë vlerësimin e rrezikshmërisë në punë dhe lidhur me punën e këtë ta inkorporoj në shenime të përgjithshme.

**3.3.** Nëse vlerësimi i rrezikshmërisë në punë dhe lidhur me punën është punuar nga ndonjë institucion profesional i licencuar për siguri në punë, ai përmban edhe

shënimet e të gjithë antarëve që e kanë bërë atë dhe shënimet tjera nga paragrafi 1(një) i këtij neni.

#### **Neni 4.**

**4.1.**Shënimet përkitazi me gjendjen ekzistuese përmbajnë:

- a)shënimet e themelore(fillimi i punës,veprimtaria,numri i të punësuarve etj);
- b)proceset teknologjike(për të gjitha njësitë),mirëmbajtjen,shenjat e rrezikut për jetë dhe shëndet të punësuarve dhe regjistrin e mjeteve materjeve dhe materjaleve që përbëjnë substanca të rrezikshme;
- c)shënimet,për çdo vit,të fatkeqësive në punë(lëndimeve të rënda,kolektive, helmimeve dhe vdekjeve)dhe të smundjeve profesionale.

**4.2.**Shënimet lidhur me gjendjen ekzistuese përmbajnë edhe të dhënat për:

- a)vendet e punës,punët për kryerjen e të cilave duhet aplikuar masa të veqanta të sigurisë në punë,numrin e të punësuarve(femra,të rinjë dhe me aftësi të kufizuar),orarin e punës,turnet,punën më të gjatë se orari i plote i punës,punët me orar të shkurtuar për shkak të kushteve të vështira të punës;
- b)rrezikshmërinë në çdo vend të punës,sidomos nga rënjet,shëmbjet,rrëshqitjet, rryma elektrike,materjet kimiko-biologjike,zjarret,eksplozimet,zhurmen,pluhurin, vibrimet, rrezatimin,mikro-klimën,shkujën(rrymimi i ajrit)etj.

**4.3.**Shënimet lidhur me gjendjen ekzistuese bazohen në evidencën nga lëmi i punës,në shënime tjera ku paraqitet gjendja e sigurisë në punë,në raporte përkitazi me vendshiqimet për rastet e fatkeqësive në punë, sëmundjeve profesionale dhe në raporte tjera zyrtare.

#### **Neni 5.**

**5.1.**Analiza dhe vlerësimi i shënimeve të grumbulluara përmban:

a)kushtet që duhet plotësuar vendet e punës(sigurimi i kalimeve të nevojshme, përfshirë këtu edhe ato emergjente,sigurimi i transportit,evakuimi i të punësuarve në rast të rrezikut,sigurimi i temperaturës,lagshtisë relative,ndriqimit të vendit të punës,kufizimit të zhurmës, vibrimeve,mbrojtja nga ndikimet e dëmshme klimatike,rrezatimet etj.) dhe sigurimi i mjeteve të punës,në veqanti ato që janë të paisura me paisje mbrojtëse(nga rryma elektrike,zjarri,eksplozimi etj.).

b)aplikimin e masave(rregullave)të veqanta të sigurisë në punë;

c)analizën e të gjitha rasteve të fatkeqësive në punë dhe smundjeve profesionale, duke i veqar burimet,shkaqet,mënyrat,llojet etj.;

ç)analizën e të gjitha çrregullimeve të procesit të punës,të cilat do të kishin pasoja të dëmshme për siguri në punë,shëndet të punësuarve dhe mjedis të punës,

d)vlerësimin e rrezikut të mbetur për lëndim në punë,sëmundje profesionale, çrregullim të procesit të punës,duke i shfrytëzuar metodat adekuate për analizë të rrezikut.

**5.2.**Në analizën e vlerësimit të rrezikshmërisë në punë dhe lidhur me punën,duhet veqar lëshimet në aplikimin e masave të përgjithshme,të veqanta dhe të masave tjera të sigurisë në punë,për shkak të të cilave ka ardhur te pasojat e dëmshme,si dhe aplikimin e masave të cilat do ta pamundësojnë përsëritjen e rasteve të tilla,respektivisht zvogëlimin e tyre në masë minimale.

## **Neni 6.**

**6.1.**Plani i masave që duhet ndërmarr për evitimin e rrezikshmërisë në punë dhe lidhur me punën përmban:

**a)**aplikimin e masave të përgjithëshme dhe të veqanta të sigurisë në punë, respektivisht masave tjera të cilat punëdhënësi duhet ti ndërmerr me qëllim të evitimit të burimeve të rrezikshmërisë në punë;

**b)** afatet,përsoneat përgjegjës për aplikimin e masave,si dhe mënyrën e kontrollimit në aplikimin e këtyre masave.

**6.2.**Plani i masave hartohet unik për të gjitha proceset teknologjike dhe shërben si bazë për veprim të përsoneave përgjegjës në proceset e punës.

**6.3.**Me plan duhet të caktohen masat e sigurisë në punë,konformë rrezikshmërisë së përcaktuar në procesin e punës,vendit të punës dhe numrit të punësuarve.

## **Neni 7.**

**7.1.**Dokumentacioni që i bashkëngjitet vlerësimit të rrezikshmërisë në punë dhe lidhur me punën,përmban përshkrimin e:

**a)**punëve për të cilat është i nevojshëm aftësimi paraprak për punë të sigurt;

**b)** punëve të cilat kryhen në kushte të veqanta;

**c)** hollsishtëm të mjeteve,materjeve dhe materialeve që përbëjnë substanca të rrezikshme,duke i caktuar vlerat e lejuara të përdorimit,respektivisht koncentrimit të tyre në mjedisin e punës,konformë standardeve ndërkombëtare;

**ç)**mjeteve dhe pajimeve tjera të punës me rrezikshmëri të shtuar;

**d)**hollsishtëm të lokaleve të punës për të cilat duhet hulumtuar mjedisi i punës dhe

**dh)**punëve te të cilat duhet përdorur mjete shitesë për siguri në punë.

**7.2.**Dokumentacioni pjesërishtë mund të paraqitet edhe në formë grafike,me fotografi,me anë të gjirimit dhe në mënyrë elektronike.

## **HARTIMI I VLERËSIMIT TË RREZIKSHMËRISË NË PUNË DHE LIDHUR ME PUNËN**

### **Neni 8.**

**8.1**Vlerësimin e rrezikshmërisë në punë dhe lidhur me punën e harton grupi punues i caktuar nga punëdhënësi,me përgaditje superiore profesionale të drejtimeve adekuate(teknike, mjekësia e punës,kimisë,biologjisë,bujqësisë,pylltarisë etj.).

**8.2.**Udhëheqësi dhe antarët e grupit punues,pos që duhet të kan përgaditje adekuate profesionale,duhet të kanë edhe përvojë pune në lëmin e sigurisë në punë,mbrojtje të shëndetit të punësuarve dhe mjedisit të punës.

**8.3.**Për hartimin e vlerësimit të rrezikshmërisë në punë dhe lidhur me punën,punëdhënësi mund të angazhojë edhe ekspert të jashtëm.

**8.4.**Hartimin e vlerësimit të rrezikshmërisë në punë dhe lidhur me punën,punëdhënësi mund t'ia besoi ndonjë subjekti tjetër,respektivisht institucioni profesional për siguri në punë,i licencuar për ushtrimin e asaj veprimtarie.

### **Neni 9.**

Vlerësimi dhe masat për evitimin e rrezikshmërisë në punë dhe lidhur me punën, bazohen në dispozitat e Ligjit për Siguri në Punë,Mbrojtje të Shëndetit të Punësuarve dhe Mjedisit të Punës.

### **Neni 10.**

**10.1.** Vlerësimi i rrezikshmërisë në punë dhe lidhur me punën, bazohet në gjendjen ekzistuese në aspektin e aplikimit të masave të sigurisë në punë dhe është dokument i cili i nënshtrohet rivlerësimit konform ndryshimeve në procesin teknologjik, i cili ndikon në sigurinë e jetës, shëndetit dhe mjedisit të punës.

**10.2.** Shqyrtimi i vlerësimit të rrezikshmërisë në punë dhe lidhur me punën, patjetër bëhet me rastin e fatkeqësisë në punë, të sëmundjeve profesionale, çrregullimeve në procesin e punës, të cilat kanë mundur të shkaktojnë pasoja të dëmshme për siguri në punë, shëndet të punësuarve, mjedis të punës dhe në bazë të aktvendimit të inspektorit të punës.

**10.3.** Shqyrtimin e vlerësimit të rrezikshmërisë në punë e bënë punëdhënësi apo në bashkëpunim me ndonjë subjekt profesional të sigurisë në punë.

### **MBIKQYRJA**

#### **Neni.11.**

Mbikqyrje në zbatimin e dispozitave të kësaj Rregullorje, ushtron Agjencioni Ekzekutiv i Inspektoratit të Punës.

#### **Neni 12.**

Inspektori i punës, nëqoftëse konstaton se punëdhënësi nuk e ka hartuar, respektivisht nëse konstaton parregullësi në vlerësimin e rrezikshmërisë në punë dhe lidhur me punën, me aktvendim do ta urdhëroi punëdhënësin për hartimin, respektivisht evitimin e atyre parregullësive.

### **DISPOZITAT KALIMTARE**

#### **Neni 13.**

Punëdhënësit detyrohen të sigurojnë kushtet dhe masat për zbatimin e dispozitave të kësaj Rregullorje, brenda afatit prej tre muajsh, nga dita e hyrjes në fuqi.

#### **Neni 14**

Dispozitat e kësaj Rregullorje zbatohen në tërë territorin e Kosovës.

### **HYRJA NË FUQI**

#### **Neni 15.**

Rregullorja hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Ministri i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenjes Sociale.

**Prishtinë, gusht 2004.**

**MINISTRI  
I MINISTRISË SË PUNËS DHE MIRËQENJES SOCIALE  
Ahmet Isufi**